



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlasna

Nr. 1-162  
Br.

Data 22.10.2018  
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI, mbledhja e 13) me dt.30.10.2018 ( e martë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

## R E N D   D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e sheshit të qytetit
4. Shqyrtimi i raportit 9 mujor financiar i Kryetarit të Komunës
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së
6. Zgjedhja e Këshillave të fshatrave dhe Lagjeve Urbane sipas Rregullores nr.-I-48, të dt.30.04.2015
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

*Burim Gërguri*  
Burim Gërguri





Dalës-Izleazna

Nr. 1/2018  
Br. 1

Data 26.09.2018  
Datum

OBILIQ-OBILIQ

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.26.09.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm janë këta anëtarë:** Burim Gërguri, Labinot Mirena, Enver Gashi, Qëndresa Dubova, Florije Jashari, Shaip Paloja, Fatos Kurshumlija, Fatmir Bekteshi, Arbnore Nasufi, Lulzim Sadiku, Hysni Mjeku, Samire Berisha, Aziz Bici, Xhezide Dragusha, Armend Rushiti, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Spasic

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ajet Berisha, Nënkyetar i Komunës, Përparim Klinaku, drejtor i adm. së përgjithshme, Naim Miftari, drejtor i DSHPE-së, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, Burim Ismaili, drejtor i DI-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DFEZH, Agim Spahiu, drejtor i DKA-së, Ferid Hashani, drejtor i bujqësisë, Fitore Hashani, drejtoreshë e DMM-së, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, Eljesa Terbunja, përf. i Handikos-it, përf. e OSBE-së  
Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### REND DITE

1. Arsytimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Buxhetit për vitin 2019-2021
4. Shqyrtimi i kërkesës për transferimin e mjeteve në kategorinë paga dhe medijtje (DEFZH)
5. Shqyrtimi i kërkesës së Handikos-it
6. Shqyrtimi i kërkesës së BIK-ut
7. Të ndryshme

**Burim Gërguri** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe propozoi që në pikën e 3, të rendit të ditës të futet kërkesa e MAPL-së, për rishqyrtimin e vendimeve të Kuvendit komunal të dt.31.08.2018.

**Fatos Kurshumlija** – Pyet se kur e ke pranue kërkesën për rishqyrtim dhe a kishim mund me pasë edhe ne sot kërkesën e tillë.

**Burim Gërguri** – Po gjithsesi do tua dërgojmë edhe juve, ashtu qysh jemi marrë vesh. Ne e kemi pranue kërkesën për rishqyrtim me dt.20.09.2018.

**Aziz Bici** – Propozoj jo të futet në rend dite, por kjo komplet të bjen poshtë dhe të mos shqyrtohet as në seancat e ardhshme, derisa ne të mos kemi investitorë serioz për dhënjën në shfrytëzim të kësaj prone.

**Lulzim Sadiku** – Mua më intereson pse nuk më ka ardhë ftesa zyrtare, as emali në takimin që e kemi pasë në restorant “Shega”.

**Burim Gërguri** - Në takimin që e kemi pasë me ftesë të Kryetarit të Komunës, realisht nuk ke marrë pjesë. Në atë takim ka qenë edhe z.Hysni Mjeku i ftuar, i cili nuk ka mund të vjen, ndërsa për ty nuk e di se a të ka ardhë emaili apo jo. Unë e di se z.Aziz Bici, është ftuar me email dhe telefon për takimin që e kemi pasë me shefat e grupeve në sallë të Kuvendit, kur ju kam ftue për rishikimin e planit të punës së Kuvendit dhe buxhetin.

**Lulzim Sadiku** – Kryesues është një gabim teknik sepse as nuk më ke dërgue ftesë, por edhe në emailin tim nuk figuron se më ke ftue në takim.

**Burim Gërguri** - Nëse, ka ndodhë gabim teknik, atëherë kërkoj falje.

**Aziz Bici** - Kërkoj nga ju kryesues dëshmi se më keni dërgue email dhe më keni ftue sepse përmes telefonit kam qenë i ftuar, por përmes emailit jo. Ju bëj me dije se asnjëherë nuk do ti përgjegjem

thirrjeve përmes telefonit, ndërsa përmes emailit i shqyrtoj. Në asnjë takim unë nuk kam qenë i thirrur përmes emailit.

**Burim Gërguri** – E kam dëshminë dhe do ta sjellë.

**Shaip Paloja** - Njëherë po e votojmë rendin e ditës, ashtu qysh na ka ardhë në material, pastaj nëse votohet le të futet në rend dite shqyrtimi i dhënjes në shfrytëzim të tokave komunale.

Pas diskutimeve, miratohet rendi i ditës me 14 vota "Për" dhe me 2 vota "Kundër" (Aziz Bici dhe Xhezide Dragusha) me ndryshimin dhe plotësimin e cekur më lartë.

### 1. Pika e parë e rendit të ditës –

**Mungoi:** Linda Sadiku, me arsye, ndërsa Agon Mjekiçi pa arsye.

### 2. Pika e dytë e rendit të ditës –

**Lulzim Sadiku** - Në mbledhjen e fundit është marrë një vendim me 9 vota "Për" 3 vota "Kundër" dhe 4 vota "Abstenim". Unë ju lus kryesues për shkak të parimeve të qytetarëve, për shkak të ndjeshmërisë së tokës së dhënë në propozime të shkruhen emrat e atyre që votojnë "Për" atyre që votojnë "Kundër" dhe atyre që abstenojnë. Ju lus që këtë përmirësim ta bëni për arsye se nuk është bërë. Unë kam vërejtje sepse emri im nuk figuron me emër e mbiemër në procesverbal kur kam votue "Kundër" dhënjes së këtyre pronave, në mënyrën qysh janë dhënë, e jo të mos dihet pas një kohe se kush ka votue "Për" dhe kush "Kundër". Vërejtja e dytë është te dhënja e pronës për një trafo dhe ne pjesa më e madhe e anëtarëve të Kuvendit komunal, kemi bisedue që të jepet një tokë në sipërfaqe prej 4 m<sup>2</sup> për lokalitetin që është më afër dhe të lidhet kolegji amerikan në atë trafo. Ndërsa, ju e keni shkruar se aprovohet kërkesa nga American school of Kosova, për vendosjen e trafos në pronën komunale me numër kaq e kaq. Ne atë ditë të gjithë kemi qenë për atë që ajo pronë të ndahet për lokalitetin ku është më së afërmi dhe njëkohësisht të emërohet një trafo që i shërben edhe kolegjit amerikan që po ndërtohet aty.

**Burim Gërguri** – Sqarimi është në 2 paragrafat më lartë, të cilët mund ti lexoni dhe vendimi kështu, nuk është marrë, që sigurisht se e ke pa vendimin kur të ka ardhë.

**Lulzim Sadiku** – Sqarimin e pashë, por problemi është te vendimi qysh e ke përpilue dhe po vendimi më ka ardhë.

**Aziz Bici** – Në rast se duhet të kërkojmë që secilit veç e veç të na shkruhen emrat, atëherë edhe kërkesë e imja është që kur votojmë vazhdimisht të shkruhet së paku emri im dhe i grupit. Në procesverbal poashtu, figuron emri i Kryetarit dhe Nënkryetarit, të cilët fare nuk kanë qenë prezentë në mbledhjen e kaluar. Pas diskutimeve, aprovohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 17 vota "Për" dhe 2 vota "Abstenim" (Aziz Bici dhe Xhezide Dragusha) me vërejtjet e cekura më lartë.

### 3. Pika e tretë e rendit të ditës –

**Burim Gërguri** – Të nderuar anëtarë të Kuvendit komunal, ne i kemi 5 vendime për dhënjen e pronës, vendimin përfundimtar dhe është një vendim paraprak për kryerjen e procedurave për dhënjen e pronës në shfrytëzim. E kemi kërkesën e parë, vendimin nr.128, për dhënjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale Obiliq, dhe Komisioni për dhënjen e pronës komunale në shfrytëzim ka rekomandue që përfitues i ofertës për periudhën 99 vjeçare, për ngastrën kadastrale P 72602001-00505-5, në sipërfaqe prej 2698 m<sup>2</sup>, P 72602001-00503-1, në sipërfaqe prej 6653 m<sup>2</sup> zona kadastrale Baimoc, të shpallet Burimi sh.p.k.

**Lulzim Sadiku** - Unë kam kërkuar që këto parcela të cilat janë marrë në vitin 2004-2005, të analizohen mirë për secilën veç e veç dhe atë ditë ka qenë këmbëngulja juaj që të votohen në paketë. Unë kërkoj që konkretisht të bëhet analizë e thukët. Këta, kur e kanë marrë tokën, e kanë marrë me qëllimin se do ta rritin punësimin, do ta zvoglojnë papunësinë, do ta rritin ekonominë etj. Unë kërkoj që renditja të bëhet në formë të ndryshme, për secilin vendim të bëhet në formën e vet.

**Aziz Bici** – Ju bëjë thirrje tërhiquni nga marrja e vendimeve për këto parcela dhe kërkoj që kur votohet të shenohet kush është "Për" dhe kush është "Kundër".

**Labiot Mirena** – Kërkoj pse të mos shkohet në paketë sepse ne po e dijmë se këto toka po jepen në shfrytëzim. Prandaj, pse me votue në bazë të zonave kadastrale njëzet herë kur mund të shkojmë në paketë

dhe krejtë ata që votojmë për toka besoj se duhet me votue për secilën tokë sepse ne nuk kemi bërë ndasi njërën prej tjetrës.

**Burim Gërguri** – duhet të votohet parcelë për parcelë dhe ju keni të drejtë në pikën 4, të nenit 39, të Rregullores së punës, me vendosë formën se qysh doni me votue.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota “Për” 3 vota “Kundër” (Aziz Bici, Xhezide Dragusha dhe Lulzim Sadiku) dhe 4 vota “Abstenim” (Shaip Paloja, Arbnore Nasufi, Fatmir Bekteshi dhe Fatos Kurshumlija) morën këtë:

#### V E N D I M

**Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit “Burimi” SH.P.K.**

**Burim Gërguri** - Tani kemi ngastrën kadastrale P 72614055-01790-24, në sipërfaqe prej 3221 m<sup>2</sup> ZK Obiliq, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme, Komisioni rekomandon që përfitues i kësaj parcele të jetë NTP “Union”.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota “Për” 3 vota “Kundër” (Aziz Bici, Xhezide Dragusha dhe Lulzim Sadiku) dhe 4 vota “Abstenim” (Shaip Paloja, Arbnore Nasufi, Fatmir Bekteshi dhe Fatos Kurshumlija) morën këtë:

#### V E N D I M

**Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit N.T.P. Union.**

**Burim Gërguri** - Për ngastrën kadastrale P 72614055-01790-28, në sipërfaqe prej 1891 m<sup>2</sup> P 72614055-01790-30 në sipërfaqe prej 1004 m<sup>2</sup> dhe P 72614055-01790-11 në sipërfaqe prej 4502 m<sup>2</sup> ZK Obiliq, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme, Komisioni rekomandon që përfitues i kësaj parcele të jetë “Agro kor” fabrika e sheqerit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota “Për” 3 vota “Kundër” (Aziz Bici, Xhezide Dragusha dhe Lulzim Sadiku) dhe 4 vota “Abstenim” (Shaip Paloja, Arbnore Nasufi, Fatmir Bekteshi dhe Fatos Kurshumlija) morën këtë:

#### V E N D I M

**Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit “Agro kor” SH.P.K.**

**Burim Gërguri** – Tash, para votimit kërkoj që z.Enver Gashi ta liroj sallën për shkak të ligjit dhe Rregullores së punës.

Pas kësaj z.Enver Gashi e liron sallën e Kuvendit komunal.

**Burim Gërguri** – Sipas rekomandimit të 4, të Komisionit për ngastrën kadastrale P 72614055-01279-15, në sipërfaqe prej 577 m<sup>2</sup> , P 72614055-01279-10, në sipërfaqe prej 2451 m<sup>2</sup> , P 72614055-01279-7, në sipërfaqe prej 2504 m<sup>2</sup> , P 72614055-01279-4, në sipërfaqe prej 2973 m<sup>2</sup> dhe P 72614055-01279-3, në sipërfaqe prej 2881 m<sup>2</sup> ZK Obiliq, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme, rekomandohet që përfituesi i kësaj parcele, të shpallet Poligoni i shenjëtarisë Katana.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota “Për” 4 vota “Kundër” (Aziz Bici, Xhezide Dragusha, Lulzim Sadiku dhe Samire Berisha) dhe 1 votë “Abstenim” (Fatos Kurshumlija) morën këtë:

#### V E N D I M

**Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit Poligoni i Shenjëtarisë “Katana” SH.P.K.**

Pas votimit z.Enver Gashi hyn në sallën e Kuvendit komunal.

**Burim Gërguri** – Sipas rekomandimit të 5, të Komisionit dhe kërkesës së MAPL-së të rishikimit të vendimit nr.1-132, kemi ngastrën kadastrale P 72614051-00562-1, në sipërfaqe prej 10503 m<sup>2</sup> ZK Milloshevë, bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme, rekomandohet që përfitues i kësaj parcele të jetë ofertuesi Sami Saraqi.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota “Për” 3 vota “Kundër” (Aziz Bici, Xhezide Dragusha dhe Fatos Kurshumlija) dhe 4 vota “Abstenim” (Labinot Mirena, Shaip Paloja, Arbnore Nasufi dhe Fatmir Bekteshi, morën këtë:

## V E N D I M

**Për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë ofertuesit: Sami Saraqi.**

**Burim Gërguri** – e kemi edhe kërkesën e fundit për rishikim, që është vendim paraprak, vendimi nr.135, poashtu është edhe kërkesa e MAPL-së për rishqyrtim në ZK Baimoc, për ngastrat kadastrale P 72602001-01235-0, në vendin e quajtur Kuke, lloji i shfrytëzimit të parcelës bujqësore kullosë klasa e 3, në sipërfaqe prej 23881 m<sup>2</sup> P 72602001-01236-1 në vendin e quajtur “KUKË”, lloji i shfrytëzimit të parcelës bujqësore kullosë, klasa e 3, në sipërfaqe prej 480 m<sup>2</sup>, e evdientuar në çertifikatën e pronës nr.05-1683-2018, e dt.29.06.2018, ZK Babimoc, K.Obiliq e evidentuar si pronë “P.SH.Kuvendi komunal Obiliq”.

-Ngastra kadastrale P 72602001-01236-2, në vendin e quajtur “KUKË VALOGË”, lloji i shfrytëzimit të parcelës rajon ujqor, në sipërfaqe prej 18782 m<sup>2</sup> e evidentuar në çertifikatën e pronës nr.05-1683-2018, e dt.29.06.2018, ZK Babimoc, K.Obiliq e evidentuar si pronë “P.SH.Kuvendi Komunal Obiliq”.

-Ngastra kadastrale P 72602001-00504-0, në vendin e quajtur “KALDRMË”, lloji i shfrytëzimit të parcelës rajon ujqor në sipërfaqe prej 447 m<sup>2</sup> e evidentuar në çertifikatën e pronës nr.05-1683-2018, e dt.29.06.2018, ZK Babimoc, K.Obiliq e evidentuar si pronë “P.SH.Kuvendi Komunal Obiliq”.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota “Për” 3 vota “Kundër” (Lulzim Sadiku, Aziz Bici, Xhezide Dragusha) morën këtë:

## V E N D I M

**Paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Babimoc.**

### **4.Pika e katërt e rendit të ditës –**

**Kryetari** – Ju e dini të gjithë se tani Komuna e Obiliqit, e ka mundësinë e shfrytëzimit të buxhetit të tantimës, që rrjedhë nga Ligji për Obiliqin dhe shuma është 4,975,000 €, me mundësi ulje apo ngritje varësisht prej eksploatimit të thëngjillit. Buxheti në bazë të kornizave buxhetore në total është 7,196,0593 €, të hyra vetanake janë 1,35000,562 €, grandit i përgjithshëm është 2,782000,49 €, grandit i Arsimit është 2,671,000,206 €, grandit i shëndetësisë është 646,000,470 €, kështu që totali i grandeve është 6,100,000,169 €. Unë i falenderoj të gjithë anëtarët e Kuvendit, të cilët kanë kontribue në përpilimin e buxhetit. Tani po filloj prej projekteve kapitale, në DSHPE për ndriçim publik janë të ndara 130,000 €, dhe planifikohet që të përmbyllet në total çështja e ndriçimit publik. Shtruarja e rrugëve me zhavorr është 40,000 €, sinjalizimi horizontal dhe vertikal është 30,000 €, ndërtimi dhe mirëmbajtja e stacioneve të qytetit 10,000 €, rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në Obiliq 50,000 €, rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave 20,000 €, që në total të DSHPE-ja, janë 280,000 €.

**Fatos Kurshumlija** – Ne e kemi buxhetin e vjetër.

**Burim Gërguri** – Rekomandimet e KPF-së, ju kanë ardhë në emailin zyrtar.

**Kryetari** – Te Drejtoria e infrastrukturës, hartimi i projekteve, ne kemi planifikue që kjo linjë të rritet në 150,000 €. Rregullimi i kanalizimit në Obiliq, është 80,000 €, bashkëfinancimi është 350,000 €, asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve në Obiliq është 528,396 €, që në total janë 1,108,396 €. Te DPUKP, hartimi i planit zhvillimor komunal dhe hartat zonale janë 100,000 €, eksproprijim janë 200,000 €, që në total janë 300,000€. Te DMM-ja, 100,000 €, janë për rregullimin e parqeve në Komunën e Obiliqit, mbjellja e drunjëve dekorativ 105,000 €, furnizimi me kontejnerë 10,000 €, që në total janë 215,000 €. Te DSHMS-ja, blerja e 2 autoambulancave 80,000 €, pajisje mjekësore për QKMF dhe servisim janë 20,000 €, inventarë për QKMF janë 25,000 €, renovimi i objekteve në QKMF, AMF dhe QMF, 15,000 €, pajisje elektronike QKMF, AMF dhe QMF janë 10,000 €, që në total buxheti është 150,000 €. Te DKRS-ja, rregullimi i fushave sportive, janë 70,000 €, fusha e trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike 50,000 €, që në total janë 120,000 €. Te Drejtoria e Arsimit, renovimi i shkollave, janë 23,658 €, blerja e kaldajave dhe instalimi 25,000 €, rregullimi i oborrit dhe rrethoja e shkollës, 35,000 €, që në total janë 83,658 €. Ndërsa, buxheti total për investime kapitale është 2,257,054 €. Pastaj, është planifikimi i buxhetit që na ka ardhë në Kornizën e dytë buxhetore, nga Ministria e financave, nga Ligji për Obiliqin janë 4,972,124 €, e cila thashë në fillim se mund të ndryshoj varësisht nga eksploatimi i thëngjillit. Sipas të gjitha statistikave, ne

shpresojmë se edhe 600,000 €, do të rritet për vitin e ardhshëm. Një laborator mobil është planifikue për ambient në vlerën prej 350,000 €. Parqet në Komunën e Obiliqit janë 480,000 €, pajisje mjekësore ultrazëri 20,000 €, laboratorë për analiza 35,000 €, digjitalizimi QKMF, AMF dhe QMF, 10,000 €, dhe pajisje mjekësore për QKMF 5,000 €. Renovimi i Palestrës sportive 55,366.50 €, shtatorja “Xhavit Haziri” 120,000 €, dhe inventarë për Shtëpi të kulturës 30,000 €. Asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve në Obiliq 1,719,633.50 kogjenerimi 530,000 €, që në total projekte kapitale janë 4 milion. Mallra dhe shërbime, janë trajtime shëndetësore 5,000 €, fushata vetëdijësuese 10,000 €, material laboratorik 28,992.50, pajisje për sport dhe kulturë 20,000 €, mirëmbajtja e rrugëve në Obiliq 10,000 €, trajnime, kurse për nxënës 5,000 €, që në total mallrat dhe shërbimet janë 78,929.50. Te subvencionet, janë paraparë 2 doktoratura, 6 mastera, 100 bursa, për studentë dhe 60 bursa për nxënës në vlerën prej 82,800 €, transporti i nxënësve 10,000 €. Sëmundjet kancerogjene, respiratore etj. 70,000 €, subvencioni i klubeve, OJQ-ve dhe rini 70,000 €, subvencioni i fermerëve 150,000 €, subvencioni i rrymës për qytetarë 300,000 €, që në total janë 682,800 €. Te burimet njerëzore, 1 zyrtar për sallën në Plemetin, zyrtar administrativ për Palestrën sportive “Adem Jashari” mirëmbajtje për Palestrën sportive “Adem Jashari” zyrtar administrativ në Shtëpi të kulturës, mirëmbajtës për Shtëpi të kulturës, bibliotekist në Shtëpi të kulturës, bibliotekist në Shtëpi të kulturës në Plemetin, 2 mjekë, 2 teknikë, 2 zyrtarë për Prokurim, 7 pozita sipas ligjit për zonën e rrezikuar mjedisore, 3 pozita për laboratorë mobil, 15 për kompaninë e mirëmbajtjes parqe dhe sipërfaqe të gjelbërta, 4 pozita për zonën e interesit sipas vendimit të Qeverisë, inspektorë që në total janë 183,720 €. Shpenzime komunale janë 26,674,50 €.

**Burim Gërguri** - Unë edhe në KPF dhe në debatet e mëhershme me grupet që kemi pasë të anëtarëve të Kuvendit dhe në takimet me qytetarë u ndjeva i privilegjuar që për herë të parë si kryesues i KPF-së, po i rekomandojmë Kuvendit komunal, për aprovim një shumë prej 12,168,177 €. Mendoj se është historikisht shuma më e madhe që ndonjëherë Asambleja komunale ka marrë vendim. Ndoshta, meritë e veçantë është e Kryetarit të Komunës, që ka fillue implementimi i Ligjit për Obiliqin.

**Shaip Paloja** – E pyes Kryetarin, kur jemi te Ligji për Obiliqin, konkretisht te tantiema, se tantiema a do të jetë për vitin 2018, të disponueshme për neve, apo do të filloj në vitin 2019 dhe të shfrytëzohet në vitin 2020.

**Kryetari** – Përgjegjet se këta e kanë marrë si mostër vitin paraprak të eksploatimit të thëngjillit dhe faktikisht ne do të përfitojmë nga viti 2018, por meqë nuk është përmbyllë viti, këta e kanë marrë vitin paraprak. Edhe ju i dini problemet që kanë qenë me Haden dhe Shipitullën, mundësia e eksploatimit ka qenë ndonjëherë më e vogla në nivel të vendit. Në Kornizën e dytë buxhetore, sqarohet shumë mirë ku thuhet se kjo shifër mund të ulet, ose të rritet varësisht nga eksploatimi i thëngjillit dhe shpresoj se ka gjasa me pasë ngritje.

**Lulzim Sadiku** – Në seancën e parafundit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ishte pika e 16, ose 17 ku duhet të bëhet ndryshimi për çështjen e minjerave dhe mineraleve dhe konkretisht nëse, nuk bëhet ky ndryshim a i thithim këto të ardhura nga tantiema apo mbeten në vitin kalendarik të vitit 2019, që rrezikohemi ti marrim në vitin 2020.

**Kryetari** – Përgjegjet se është nxjerrë një vendim që të bëhet një hulumtim edhe jugu dhe veriu për shkak të specifikave që do të ndryshojnë në Termocentralet e reja, pasi që do të jetë edhe “Kosova e re”.

Është pretendue që minjera të filloj zhvillimet nga jugu, por fatmirësisht analizat dhe të gjitha rrethanat që aktualisht janë në favor të veriut kanë mbetë prapë. Ne e kemi marrë dje një vendim nga Qeveria, që është aprovue me dt.28, vazhdimi i minjerës në drejtim të veriut. Sa i përket çështjes së eksploatimit, kjo do të jetë në vitin 2020, dhe ne do ta shfrytëzojmë buxhetin e tantiemës të vitit 2019. Ne kemi kërkuar që ose të jetë e hyrë vetanake tantiema ose të mbetet grand specifik, që nëse ne nuk mundemi për shkaqe të Prokurimit, që mjetet financiare të Ligjit të barten për vitin e radhës me qëllim që ti menaxhoj Komuna. Ne mund ti drejtohem edhe Komisionit parlamentar për trajtim të buxhetit dhe i lus të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal, pa dallim politik që të loboni te anëtarët e Komisionit që janë në Parlament, që shumë nga ato që i përmendëm më heret të jenë pjesë reale.

**Aziz Bici** – Më duket i çuditshëm fakti se kërkoni miratimin nga ne të shumës buxhetore për Ligjin e Obiliqit, kur për një gjë të tillë ne nuk jemi të informuar se Komuna aktualisht ka fillue ti përmbushë dhe ti kryej obligimet për implementimin e këtij ligji, që më duket se kjo po shkon veç formalisht. Edhe përkundër projekteve të përmendura, që tingëllojnë mjaft mirë të shkruara, ne si LVV jemi dëshmitarë të keqpërdorimeve enorme, të korrupsionit me rezultat e cilësi të dobët të projekteve, që përveç votimit “Kundër” ju sigurojmë se do të përcjellim secilin projekt që planifikoni të implementoni.

**Kryetari** – Më vjen keq që e keni lexue Kornizën buxhetore, por nuk doni me pranue si realitet. Në Kornizën e dytë buxhetore, e cila është publike besoj që e keni marrë dhe e di që e keni xhelozë shumë. Sa i përket korrupsionit janë organet kompetente dhe ne do të jemi transparentë në vazhdimësi. Unë e kam një lutje për ty, mundou me bë një kërkesë te posta për me i krijue kushtet në postë sepse jashtëzakonisht po duket keq dhe meqë, je menaxher i postës të lus së paku dukjen e jashtme dhe toaletet rregulloji.

**Aziz Bici** – Sa i përket postës, për fat të keq edhe qeveritë e kaluara, por edhe qeveria e tanishme, që ju e udhëheqni me Kryeministrin dhe me ministra, i njoftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit se në këtë gjendje aq të rëndë që gjendet posta dhe telekomunikacioni, ju si parti keni arritë ti punësoni edhe mbi 150 punëtorë. Pra, ju me vetëdije jeni duke e dëmtuar postën dhe telekomin sepse sikur të varej prej meje sigurisht se jo vetëm objekti, por edhe posta dhe telekomi ashtu qysh i kanë dhënë prej 60-80 milion, qeverisjet e mëhershme, sigurisht se kishte me vazhdue ashtu. Prandaj, ju meqë i takoni partisë që është në pushtet mund të bëhemi bashkë sepse kam ide dhe e shpëtojmë postën dhe telekomin, jo vetëm në Obiliq por edhe në përgjithësi.

**Kryetari** – Ju e dini se është një inspeksion sanitar, që besoj se javën e ardhshme do t’ju vizitojnë dhe ne do të kërkojmë që nëse, nuk i plotëson kushtet të mbyllet posta. Ndërsa, ju mund ta adresoni problemin në nivelin qendror dhe të shohim se çfarë mund të bëjmë edhe do ta bëjmë. Unë flas për nivelin lokal, ndërsa për nivelin qendror e ke atje Albinin, i cili mund të merret me këtë punë.

**Aziz Bici** – Unë të inkurajoj për çdo gjë të mirë që bën për postën sepse edhe ajo edhe Komisioni ndikon te unë pozitivisht, inkurajoj që ta dërgoni menjëherë. Ndërsa, sa i përket Albinit, ai është i dëshmuar vetëm ju kthehuni interesit të qytetarëve, që e keni sjellë gjendjen aq të rëndë të qytetarit në Komunën e Obiliqit, sepse me çdo të dytin që takohemi vetëm presin qysh me dalë jashtë vendit. Edhe ky buxhet është duke vazhdue shabllon sikurse buxhetet e kaluara, që nuk garanton as zhvillim ekonomik, as punësim dhe për këtë ju po i merrni edhe këto prona të pakta të Komunës, e po i pasuroni xhepat e juaj. Ju bëjë thirrje të interesoheni për jetën e këtyre qytetarëve sepse për këtë e kemi marrë votën.

**Kryetari** – Të përgëzoj për komentin.

**Fatos Kurshumlija** – Kërkoj prej Kryetarit dhe prej drejtorëve, buxheti për vitin 2019 që është për investime kapitale, ne e kemi këtu kushtimisht te Drejtoria e infrastrukturës, te asfaltimi i rrugëve në zonat rurale dhe trotualet në Obiliq, po flas me shifrën e vjetër janë 528,396 €, të paktën me qenë të specifikuara emërtimi i rrugëve dhe trotuaresve, të cilat kanë me qenë për çdo Drejtori. Është edhe rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit, që këtu mund të hyjë edhe ndonjë fshat, por të paktën ne duhet të dijmë se ku do të shkojnë këto investime, që nesër kur të dalim para qytetarëve t’ju tregojmë saktësisht se ku do të shkoj buxheti i vitit 2019.

**Kryetari** – Sa i përket çështjes së infrastrukturës, ne kemi biseduar edhe në takimet e mëhershme dhe është një fat i mirë se ne e kemi mundësinë edhe 1,719,000 €, nga buxheti që vjen nga ligji. Duke u bazuar e kemi marrë në fokus infrastrukturën krahas projekteve tjera dhe ne kemi biseduar në 2 takime me anëtarë të Kuvendit rreth kësaj çështjeje. Unë i falenderoj shumë për projektet që i kanë sjellë dhe një prej projekteve, që është dukë më interesante është i z.Shaip Paloja, rreth kyqjes së nxemjes qendrore prej pajimeve xehtare, meqë është deri aty gypi. Ne do të fillojmë në start me bë si pilot projekt për me mund me pa se sa do të na kushtoj kostoja. Ne me shefat e grupeve do t’ia bëjmë një kërkesë KEK-ut dhe nëse është e nevojshme do të shkojmë bashkarisht edhe në Bordin e KEK-ut, me trajtue këtë çështje për me pa se sa mund të jetë e realizueshme. Unë i falenderoj edhe anëtarët tjerë të Kuvendit për projektet që i kanë sjellë dhe mendoj se mbi 90 %, e këtyre që janë të listuara këtu do të përmbyllen. Unë besoj realisht dhe është fat i madh për neve, që tani Komuna jonë është Komuna më e pasur në ballkan pavarësisht që dikush

këtu a xhelozon, apo nuk xhelozon. Kjo është vlerë e krejtë qytetarëve, e jo vetëm e imja sepse të gjithë kemi kontribue, aty ku kemi mund me shtye si proces. Ju, z.Aziz duhet të bëheni pak më i disiplinuar sepse të kanë votuar qytetarët dhe duhet me pasë pak respekt. Poashtu, mos më ndërprej në fjalë sepse nuk është e sinqertë, po bisedojmë për një punë shumë madhore, për Ligjin e Obiliqit, për projektet kapitale, të cilat do ti gëzojnë qytetarët. Ju, duhet të sjellni propozime, e jo ankesa dhe a e ke sjellë ndonjë kërkesë për rrugë, park apo diçka tjetër me trajtue. Unë i kam mbi 100 projekte këtu, duke i falenderuar prapë po them të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal, shoqërinë civile, që kanë ofruar ide të ndryshme, Ekzekutivin pa diskutim që ka bërë një punë jashtëzakonisht të madhe.

**Burim Gërguri** - Është Rregullorja e punës së Kuvendit, që na përcakton të drejtën e fjalës dhe kur dikush debaton është çështje etike, që ne me respektue parafolësin. Keni ndërhye pa nevojë dhe po ta japë fjalën për shkak të moshës, e jo Rregullores sepse 4 herë e ke marrë fjalën.

**Aziz Bici** – Kryesues, lexoje Rregulloren më mirë ndërsa ju Kryetar nëse, mendoni se duhet me i disiplinue anëtarët e Kuvendit ashtu qysh i ke disiplinue disa, ashtu qysh të vyejnë ty për me të votue, bëhu i bindur se mua asnjëherë nuk do të mundesh me më disiplinue. Kjo, vetëm për një arsye se asnjë gjë tjetër me ty nuk kam, por nuk do të jem i disiplinuar ndaj punëve, ndaj hajnive që jeni duke i bërë, ndaj të këqijave që po i bëni sepse kjo infrastrukturë që po punohet, nuk e di se për kend ke me punu kur vazhdimisht po them se është gjendje e rëndë e papunësisë dhe pritet që qytetarët të dalin jashtë vendit. Sa i përket kërkesave, është e vërtetë se nuk i kam bërë, por gjithmonë kam reague për shkollën në Mazgit, për ambullantat se në çfarë gjendje i keni lënë tash e sa vite.

**Labinot Mirena** – I lumtë të gjithë drejtorëve dhe Kryetarit për përgatitjen e këtyre projekteve, ndërsa sa i përket asambleistit të VV, që tha se Kryetari i ka bërë disa grupe këtu, mund të them se ne kemi marrë vota dhe kemi kërkuar besim të qytetarëve për me i përkrahë projektet, të cilat janë në të mirën e tyre. Mua, askush nuk më ka bind, as nuk mund të më bind për diçka që është e dëmshme për Komunën sepse unë jetoj këu, në Obiliq. Prandaj, votoj për atë që besoj dhe e kemi marrë përkrahjen edhe në mandatin e kaluar dhe në këtë mandat me besim të qytetarëve se kemi punue dhe jemi duke punue në të mirën e tyre. Sa i përket çështjes së punësimit, ju e akuzuat partinë në pushtet se po punëson në postë, e tash janë duke ikë rinia jashtë dhe tash, nuk e di a janë punësu, apo ikun rinia jashtë. Nëse, jemi për punë po punojmë të gjithë, e jo vetëm me kritikue, e me fol gjithçka zi. Unë vetëm ju përgëzoj për projektet dhe për gjithçka që është në të mirë të qytetarëve të Obiliqit dhe votën time e kanë pa marrë parasysht kushdo që është në qeveri nëse, unë jam këtu ku jam do ta kenë përkrahjen time.

**Aziz Bici** – Sa i përket punësimit, ju njoftoj prapë se po i punësojnë dhe nuk punojnë dhe besoni se i punësojnë, marrin rroga kot, nuk rrijnë në vende të punës, bile dërgojnë emaila se nuk është në kompetencën tënde. Qytetarët janë të maltëruar sepse nuk kryhen shërbimet si duhet dhe për këtë po them se ju duhet të bashkëpunoni me secilin vetëm për shkak që qytetari të jetë kënaqur dhe të kthen besimin te institucionet tona. Qëllimi im është vetëm ky.

**Kryetari** – Besoj se qytetarët e kanë të qartë dhe kanë kontribue. Sa i përket buxhetit që e potencova më heret, unë jam njeriu më i lumtur që Obiliqi i ka pasë këto rrethana që kemi veprue deri më tani, që ka shkaktue një padrejtësi të madhe. Këtë çështje e kanë nisë shumë qytetarë para meje dhe unë aty ku e kam gjetë e kam vazhdue, por e di se në vitin 2014 i kemi pasë 1 milion e 200,000 €, për investime kapitale, në vitin 2015, i kemi pasë 987,000 €, për investime kapitale. Poashtu, e di se qytetarët në vitin 2019 i kanë 7,300,000 €, investime kapitale, pa i llogaritë edhe 3 milion që vijnë nga Ministrinë e ndryshme, pa e llogaritë se edhe investitorët tjerë do të krijojnë mundësi të mira për investime dhe të na ofrojnë edhe nga Termocentrali i ri nëse fillon. Ne ju kërkojmë falje qytetarëve nëse, do t'ju shkaktojmë zhurmë, pengesa në komunikacion dhe po krenohemi që në vitin e ardhshëm mbi 10 milion do të investohen në Komunën tonë, që nuk ka ndodhë ndonjëherë.

**Hysni Mjeku** – Mendoj se asnjëherë nuk kemi punuar më mirë dhe më mbarë se deri më tani për aprovimin e këtij buxheti, duke falenderuar edhe Drejtorinë e financave, kryesuesin që në x raste, kemi pasë takime konsultative me grupe parlamentare, me anëtarë të Kuvendit dhe me të gjithë ata që kanë qenë të interesuar. Për këtë arsye e kemi dhënë dritën e gjelbërt në KPF, me të vetmin qëllim që për herë të



parë të kemi një buxhet mbi 7 milion në Komunën tonë, pa e llogaritur Ligjin për Obiliqin. Në Kuvend këtu, na është thënë se çdo zonë kadastrale, apo më mirë të them çdo fshat, çdo lagje që ka nevojë për projekte kapitale, ti paraqesin kërkesat në KPF dhe përmes Kryetarit, se ato prapë do të kthehen në KPF. Poashtu, kemi bisedu edhe me Kryetar të fshatrave për të gjitha projektet që janë të nevojshme për vitin 2019 dhe ky buxhet po ju them sinqerisht se kësaj radhe jo që mjafton, por edhe i tejkalon nevojat tona. Mirëpo, është me rëndësi se në periudhën e ardhshme si do të menaxhohen dhe si do të implementohen në vijë nga zona e fshatit Grabofc i epërm, që besoj se Kryetari ka x projekte që neve na mungojnë për momentin dhe që duhet të realizohen, pikërisht ato projekte që e kanë kohën e nevojshme për me u implementue. Sa i përket diktateve, që u cekën më heret ju lutemi ne këtu jemi ardhë me votë të popullit dhe unë jam përfaqësues i 4 mandateve këtu, që e di rolin tim për çka jam zgjedhë, çka kërkoj dhe për mua të gjithë qytetarët janë të barabartë, që nga Breznica deri në Grabofc. Unë kur hyj në këtë sallë, nuk hyj si anëtar i PDK-së, por hyj si anëtar i Asamblesë komunale të Obiliqit dhe këtë e kam dëshmuar në 4 mandate. Kjo nuk është hera e parë që ne po japim tokë sepse kemi dhënë edhe në mandatet e kaluar psh paramendoni qysh ka qenë ambienti te Katana dhe sot kishte me qenë mbeturinë regjionale aty, por ja si duket sot. Këtu, u cekë se kur të merren vendimet të shkruhen me emra e mbiemra, por s'ka frigë pse Hysni Mjeku, e ngritë dorën për me dhënë një pronë, 10 herë le të shkruhet në procesverbal ose mos të shkruhet fare. Sa i përket postës, merre shembull postën e Fushë Kosovës dhe postën tonë dhe këtu është në pyetje menaxhimi i dobët, ajo është barnatore në krahasim me postën tonë. Unë bile kam thënë me rrënuar krejtë postën, stacionin e policisë, që me ju lëshu hapësirë qytetarëve dhe me bë një projekt të mirë. Nëse, menaxhohet kësajsoji qysh është atëherë faktikisht nuk meriton me qenë posta, aty ku edhe është. Unë jam pro këtij buxheti dhe besoj se edhe grupi parlamentar që tash po dal si partiak, si PDK psh edhe pse ju kam thënë çdoherë kur hyn në sallën e Asamblesë, nuk ka më grupe parlamentare, por ka interes qytetar dhe nëse ka interes qytetar urdhëro si grup parlamentar e ke zyren e partisë dhe zyren e kryesuesit shqyrtoji, analizoji dhe sjelli në Kuvend.

**Lulzim Sadiku** – Unë do të mundohem të jem shumë i përgjegjshëm dhe në pyetjen që ia bëra Kryetarit bukur mirë e sqaroj si përfundim i krejtë asaj kërkoi nga shefat e grupeve që të llobojnë, punojnë dhe të ecin gjërat përpara, që pajtohem plotësisht. Poashtu, shumë mirë e tha që mos me ia lënë krejtë vetes sepse një pjesë e Ligjit për Obiliqin në vitin 2009, është premtue nga Presidenti se nëse, i fitoni zgjedhjet do të bëjë kështu. Unë gjithmonë jam falenderues ndaj LB-së, ndaj atyre djemve që kanë punue shumë dhe e kanë sjellë deri në situatën kur ishte Raif Qela, aty. Unë po lidhem në gjëra, që në fakt si Komunë po kemi ngecje të mëdha dhe në nivelin qëndror nuk kemi njeri që na përfaqëson, shumë subjekte politike dhe pa asnjë njeri. Realisht ka qenë mirë të rregullohet edhe posta, të kalon Ligji i Obiliqit dhe të kalojnë shumë faktorë që janë në interes të qytetarëve. Kjo është një ngecje e subjekteve politike brenda Obiliqit, që s'po kemi njeri me i shtye gjërat. Fatmirësisht në mandatin që shkoi ka pasë problem në mes të pozitës dhe opozitës, por gjithmonë e falenderoj me emër Raif Qelën, i cili i ka shtye gjërat dhe kemi ardhë deri në këtë moment që shpresojmë se në vitin 2019, do ti gëzojmë të hyrat nga Ligji për Obiliqin. Vërtetë, unë i thashë edhe kryesuesit se kur janë mbajtë takimet për buxhet, nuk na ke ftue dhe nuk kam asnjë dëshmi se më ke ftue në ato takime. Për fshatin Sibofc, janë disa rrugë të vogla dhe po ju them publikisht se për njërin nga ato Kryetari më ka thënë se do të mundohem me krye në këtë vit kalendarik. Sot kemi ra në lajthitje dhe mendoj se fajtor për këtë është kryesuesi, i cili e ka mbajtë KPF-në ditën e hënë, ndërsa materiali më ka ardhë 5,6 ditë, më heret dhe më kanë ardhë 2 buxhete, që janë me ndryshim të numrave. Kërkoj të jemi sa më të thukët në procese që po flasim. Kërkoj që të punojnë të gjitha grupet parlamentare, e ftoj edhe Kryetarin me shkue në nivel qëndror, që të thithen të ardhurat nga Ligji për Obiliqin. KPF, ka mbajtë mbledhjen të hënën, ndërsa buxheti aprovohet të mërkurën dhe neve, materiali na ka ardhë një javë më heret dmth jemi komplet të paqartë. Dokumenti që na ka ardhë neve sjellë një paqartësi të madhe sepse ky planifikim nuk e përfshin planifikimin për mjetet financiare që vijnë për zbatimin e Ligjit për Obiliqin. Mendoj se ky planifikim nuk shenon ndonjë përparim cilësor dhe është pjesërisht i njëjtë me 4 vitet e kaluara. Vërejtjet tona fillojnë qysh te ndarja e përqindjeve nëpër kategoritë ekonomike, ku vërehet se janë 1 milion euro, në kategoritë e ndijshme mallra e shërbime, shpenzime komunale dhe subvencione. Nuk

është mirë që shpenzimet për investime kapitale, me këtë vlerë që është 30 % e buxhetit të tërësishëm, ndërsa këto 3 linja shpenzuese të kapin 15 %, të shpenzimeve të buxhetit që i bjen sa gjysma e mjeteve të investimeve kapitale. Propozoj që në linjën mallra dhe shërbime të ulen shpenzimet nga 600,000 në 450,000 €, ndërsa në linjën e shpenzimeve komunale nga 250,000 €, të ulen në 150,000 €. Te subvencionet, propozoj që shuma e mjeteve të ulet nga 150,000 në 100,000 €, dhe nga këto veprime 300,000 €, nga këto linja do të barten në investime kapitale. Te planifikimi i projekteve kapitale, do të ndalem në vitin 2019 sepse për vitin 2020 dhe 2021, pothuajse nuk ka asnjë planifikim të veçantë përveç përsëritje të projekteve të vitit 2019. Është përsëritje prapë elementi i planifikimit që Kryetari me ekipin e tij e ka bërë që 4 vite, duke mos i specifikuar projektet me emër e mbiemër. Te planifikimi për rregullimin e varrezave, janë ndarë 10,000 €, dhe këto janë të pamjaftueshme sepse kemi një mosmirëmbajtje totale të varrezave. Këtu, Kryetar mungon një plan rregullativ për varreza dhe ka qenë mirë që me ekspertët e tu, me Bashkësinë fetare, me bë një renditje sipas Rregullores, që mos me shkue toka kot. Planifikimi për drunjët dekorativ duket se i ka humbë kuptimi sepse rr.Palaj-Obiliq, është prishë 90 %, pastaj rr.Obiliq-Prishtinë, janë shtrembëruë, janë shkurtue drunjët dekorativ dhe me nda këtë shumë të mjeteve pa e shikue gjendjen reale, më duket se ka ndarje shumë të madhe të buxhetit. Rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit 200,000 €, është mirë me ditë se cilat parqe janë sepse po e aprovojmë buxhetin. Pastaj për ngritje të lapidarëve, 50,000 €, që edhe në mandatin tënd edhe më heret jemi marrë me lapidare dhe nuk e di se a po i heqim këto, apo po ndërtojmë diçka të re. Rregullimi i oborrit dhe rrethojat e shkollës, 50,000 €, është bërë njëfarë rutine 4 vjet, është punue nëpër rrethoja të shkollës, por është dashur me planifikue disa kabinete, me rregullue një kabinet të makinerisë sepse 4 vite radhazi i kemi pasë rrethojat pa i specifikue se në cilat shkolla bëhet. Unë po flas gjithnjë për dokumentin që e kam. Mendoj se këtu, duhet të bëhet një ndryshim ju garantoj se me 20,000 €, mundesh me rregullue një kabinet të makinerisë brenda shkollës teknike. Tash, besoni me 2 materiale jemi në lajthitje sepse shifrat e njejtja nuk po dalin. Te planifikimi për derivate për vetura, kam kërkuar që nga 15,000 €, të zvoglohet në 5,000 €, sepse tash janë makinat e reja, që besoj se e kanë njëfarë sigurimi. Te dokumenti që e kam marrë unë janë 95,000 €, për punëtorët për pension dhe e di se e kemi shikue edhe një listë të përbashkët, por vërtetë për një vit kalendarik janë shumë mjete. Te shpenzimet komunale, është absurd i llojit të vet të planifikosh shpenzime 168 €, për drita kryesisht, që mendoj se duhet me gjetë një formë kur të ndizen ato drita sepse shumë herë edhe në ora 8 e 30' në fshatin tim kur unë vijë ato janë ndezë në ora 9. Është mirë të bëhet një planifikim që ato drita të fiken në ora 7 dhe të ndizen më vonë. Unë nga të gjitha këto, që i thashë dua sqarim dhe tash jemi në mes të 2 dokumenteve dhe jemi të pafajshëm. Unë nuk jam ftuar as në takimin kur është mbajtur në Milloshevë, as nuk më ka ardhë dokumentacion zyrtar pasi që është mbajtur KPF-ja dhe analizën e kam bërë në bazë të materialit të vjetër, i cili më ka ardhë javën që shkoi. Nëse, këto që i thashë ju do ti futni në këo ndryshime, atëherë do të jem pro buxhetit, por nëse mbeten këto shpenzime aq të mëdha do të jem "Kundër".

**Burim Gërguri** – Në mbledhjen e KPF-së, janë ndërruar propozimet dhe atë ditë ne ju kemi dërguar rekomandimet, ndërsa për çështjet tjera konkrete është Kryetari që mundet me dhënë përgjegje. Poashtu, në ditën kur është mbajtur Kuvendi ju kemi dërguar edhe buxhetin e rishikuar.

**Aziz Bici** – Unë vetëm mund ti them z.Hysni, mos e ndiej veten aq krenar për këto 4 mandate sepse gjeneratat e reja kanë me na gjykue të gjithëve, për çfarëdo kohe. Sa i përket postës, e kërkoj përkrahjen edhe të Kryetarit dhe prej të gjithëve, nëse është nevoja edhe të mbyllet sepse unë kam argumente të mjaftueshme që vërtetë është sabotim i kësaj poste këtu. Mirëpo, qëllimi është qysh me u dëmtue posta dhe telekomi i nivelit qëndror. Në kohën kur është ndërtue dhe janë renovue postat, kjo ka qenë më heret prandaj edhe kjo postë ka mbetur ashtu edhe kur jam ardhë.

**Kryetari** – Tani, do ti përgjegjem z.Lulzim Sadiku, se linjat buxhetore, kategoritë ekonomike përcaktohen nga Ministria dhe jo vetëm Komuna jonë, por të gjitha Komunat kanë problem me mallra dhe shërbime. Prandaj, jo me i ulë, por duhet me i ngritë vlerat e mjeteve sepse dikur i kemi pasë vetëm 29 drita, ndërsa tash i ke 2,900. Ne kemi ndarë buxhet edhe 130,000 €, për ndriçim të ri dmth në bazë të kërkesave që janë përgatitë nga anëtarët e Kuvendit, nga shoqëria civile dhe takimet që i kemi zhvillue me

qytetarë, delë se patjetër duhet të rregullohemi në nivel të vendit, që mallrat dhe shërbimet të ngriten sepse i kemi krijuar afër 70 rrugë më shumë. Në këtë vit janë 50 rrugë më shumë, që vetëm borën me ua heqë po krijohen shpenzime shtesë, pastaj është mirëmbajtja dhe shumë çështje tjera. Te linjat 2020, 2021, këto prapë përcaktohen nga niveli qëndror dhe nuk janë të zërthyer prej neve, që nuk dmth se do të mbetet kështu sepse në vitin kalendarik mund të pësoj ndryshim. Te drunjët pajtohem se një pjesë e madhe po dëmtohet, por sinqerisht ne po bëjmë kërkesa në polici, kështu dje e kemi pasë një rast e kanë ndezë dhe duke shkue për Milloshevë mundesh me pa. Ne duhet të bëjmë përpjekje në vazhdimësi me i gjetë ata që janë duke i dëmtuar. Sa i përket kabineteve, ne kemi fillue me i përgatitë punëtoritë te gjimnazi dhe teknika që ndoshta i ke pa si projekte. Poashtu, jemi duke bisedue me menaxhmentin e Kosovës së re sepse neve na takon si komunitet, që atakohemi të investohet në shkollën profesionale, kabinete, punëtori për me i përgatitë kuadrot për Termocentralin e ri. Te servisimet, një pjesë e veturave janë të vjetra, një pjesë që kanë qenë të reja, as ato nuk janë të reja më dhe kemi kërkuar që me i marrë në lizing qysh i kanë marrë Komunitat tjera, dhe po shpresojmë që me u heqë ajo, por derisa nuk e realizojmë projektin tjetër janë pak mjete. Pagat jubilarë, seriozisht janë shumë, por aq kanë me shkue në pension sepse e kanë bërë vlerësimin dhe është dëshmuar se është ashtu. Sa i përket shëndetësisë, e kemi një problem që është krijuar në nivel vendi sepse Ministria e shëndetësisë dhe sindikata e kanë nënshkruar një marrëveshje të njejtë sikurse Arsimi. Tash, Arsimi e ka zgjidhë problemin se ka mund me shti në buxhetim, ndërsa shëndetësia po shpresojmë se i futë, përndryshe ne e humbim të drejtën me ligj sepse të gjithë ata që pensionohen e gëzojnë atë të drejtë. Pra, nëse nuk kemi me ia dhënë mjetet atëherë ai mundet me i marrë përmes përmbaruesit. Mirëpo, ne jemi duke bërë përpjekje përmes Asociacionit që me mund me përfshi si të planifikuar për mos me pasë telashen e njejtë. Dritat po kushtojnë, kemi pasë shumë pak e tash janë bërë shumë dhe sinqerisht po ndikon edhe në siguri dhe në aspektin e vendit të dritave, por ne shpresojmë se me negocijim përmes Ministrisë së zhvillimit ekonomik, kemi me arritë me ulë tarifën e tyre.

**Hysni Mjeku** – Unë nuk ndjehem i privilegjuar meqenëse, besimin e kam marrë nga elektorati 4 herë dhe 2 herë, kam qenë më i votuari në Komunën e Obiliqit. Unë e respektoj elektoratin e Komunës së Obiliqit, që e ka dhënë besimin e duhur dhe besoj në përkushtimin më të madh që e kam pasë, e kam dhe do ta kem do të thotë që jam në krahun e qytetarëve dhe në interesin e tyre. Prandaj, ky besim më bën të ndjehem krenar dhe besoj se deri në përfundimin e mandatit do të jem i tillë dhe do ta përfundoj me shumë sukses siç i kam përfunduar edhe shumë obligime tjera shoqërore.

**Dragan Dancetovic** – Verujem da je do sada proces planiranja budjeta za 2019 godinu, bio obiman i ozbiljan i mi cemo ispred srpske liste dostaviti nase predloge, i na taj nacin dati doprinos u planiranju ovog budjeta. Ja ocekujem da cemo sa tim budjetom ravnomerno ulagati u sve sredine i u gradsku, i u ruralnu sredine Opstine Obilic, tako da sve sredine budu ravnomerne razvijene.

**Nazmi Gashi** – Unë nuk e njohë shumë kur është buxheti në pyetje dhe kam thënë njëherë se një pension mezi po e menaxhoj, e jo gjithë këto mjete, por faleminderit që ka ardhë një kohë me diskutue dhe me pasë për çka me diskutue. Ne mund të bëjmë shumë projekte, por kur s'ka mjete mbeten vetëm në letër. Shpresoj se ky mandat do të jetë mandati më i suksesshëm dhe besoj se te planifikimi i buxhetit të gjithë e kanë pasë qëllimin e mirë. Ne kemi pasë diskutime me Kryetarin lidhur me buxhetin dhe jemi mundue me i dhënë disa mendime sa kemi mund dhe kemi ditë. Unë gjatë kontrollit të pasqyimit të buxhetit për shkak të profesionit në infrastrukturë, e kam një kërkesë për rrugët që po i shtrojmë me zhavorr, pasi që ka mjete mendoj se është mirë të bëhet një kategorizim i gjatësisë së këtyre rrugëve nga Drejtoria përkatëse, për me i asfaltue. Kjo nga fakti se mirëmbajtja e tyre po na kushton më shumë. Në një takim që e kemi pasë kanë qenë edhe anëtarët tjerë të Kuvendit, Kryetari ka qenë decidiv duke thënë se ju lus të gjithë juve anëtarëve të Kuvendit, pavarësisht nga partia të cilës i përkitni, që ti mbrojmë interesat e qytetarëve dhe të punojmë aty, ku ka nevojë pa marrë prasysh a e kanë dhënë votën, apo nuk e kanë dhënë. Mendoj se është mirë që të gjitha kërkesat e qytetarëve, ne si asambleistë me i paraqitë pa marrë prasysh se cilës parti i takon sepse drejtësia nuk humbet kurrë.

**Kryetari** – Sqaroj te rrugët me zhavorr nëse, ju kujtohet në vitin e kaluar vijë buxhetore kemi ndarë 110,000 €, ndërsa në këtë vit i kemi lënë vetëm 40,000 €, po flas për vitin 2019. Arsyeja pse janë vetëm

40,000 €, është se ne planifikojmë vetëm në raste të jashtëzakonshme, ndonjë rrugë që është shumë e gjatë dhe është numri i vogël i banorëve, që nuk mbërrimë me krye në vitin 2019. Pra, nëse kemi ndonjë problem të erërave, fatkeqësive që me pasë parasysh me pasë linjën e zhavorrit për me mund me sanue. Ndërsa, pjesa më e madhe e të gjitha projekteve që janë ardhë pikërisht ky ka qenë fokusi që e kam marrë edhe mendimin tuaj, që të fillojmë krahas projekteve tjera, fokus me pasë infrastrukturën. Unë ju garantoj se kemi me u mundue me i realizue shumë shpejt, me i bë matjet dhe besoj se në seancat e radhës keni me pasë mundësinë me i pa se cilat janë krejtë si dhe në strategjinë që planifikohet të përpilohet, që është obligim i Komunave 2019-2023, keni me pasë të saktë. Poashtu, kërkojmë nga ju që të kontriboni në renditjen e prioriteve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota "Për" dhe 3 vota "Kundër" ( Aziz Bici, Xhezide Dragusha dhe Lulzim Sadiku) morën këtë:

#### V E N D I M

##### **Aprovohet Planifikimi i Buxhetit Komunal dhe shpenzimet kapitale për vitin 2019.**

**Burim Gërguri** – Tani kemi me votue sipas ligjit për zonën e rrezikuar të Obiliqit në shumën prej 4,972,124 €, propozuar në 5 kategori, sikur Kryetari që i lexoi dhe dokumentin që e keni nga rekomandimet e KPF-së.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota "Për" dhe 2 vota "Kundër" (Aziz Bici dhe Xhezide Dragusha) e aprovuan vendimin sipas ligjit për zonën e rrezikuar të Obiliqit në shumën prej 4,972,124 €, që do të përfshihet në vendimin e planifikimit të buxhetit komunal dhe shpenzimet kapitale për vitin 2019.

##### **5. Pika e pestë e rendit të ditës –**

**Zarife Behluli** – në bazë të shpenzimit të pagave nëpër Drejtoritë komunale, në bazë të një analize të bërë nga zyra e Kryetarit mbeten 610.99 €, nga administrata 7,258.45 €, nga Drejtoria e inspeksionit 5,894.35 €, nga DSHPE, 10,113.99 dhe nga ZLK 750.42 €, transferim në zyrën e Kuvendit komunal. Ndërsa, te shëndetësia primare, që janë në një minus të madh të pagave nga ZLK 2,044.52 €, nga Drejtoria e bujqësisë 514.71 €, nga Urbanizmi 3,458.66 €, nga Ambienti 3,795.08 dhe nga Arsimi fillor 88076, që në total janë 97,888.97 €, në shëndetësinë primare. Totali i transferit është 123,756.31 €. Te DSHMS, te QKMF kemi problem sepse 1 mjek dhe 1 infermier janë pranue dhe këta qe 2 muaj punojnë pa paga sepse nuk i kanë pranuar në listën e pagave. Në bisedë me drejtorin e thesarit dhe buxhetit, ne duhet me kalue transferin e mjeteve përmes Kuvendit dhe llogaritet se në muajin e fundit aty ku ka minusa nëpër paga i mbulon Qeveria në tërë Kosovën.

**Lulzim Sadiku** – Pyet se 24,627 €, pse gjithë këto mjete në Zyren e Kuvendit komunal. Pagat e Kuvendit dihet se vijnë nga buxheti i Republikës së Kosovës

**Zarife Behluli** – Përgjegjet sepse ka pasë buxhet pak.

**Burim Gërguri** – Sqaron se këtu, fjala është për pagat për mbulim të minusave prej një kodi në tjetrin.

**Aziz Bici** – Pyetja ime është a janë punësue punëtorë të ri apo pse bëhet bartja e të hyrave në Kuvend. Pyetja tjetër është se mjetet që po kërkohen të kalojnë në shëndetësi, ju thatë se 1 mjek është punësue dhe ka punue pa pagë, çka do të ndryshonte mjekësia primare me këtë mjek dhe a ka nevojë edhe për mjekë tjerë, apo nuk ka.

**Zarife Behluli** – Përgjegjet QKMF-ja, me Ligjin e buxhetit i ka 101 punëtorë dhe kanë qenë të pambuluara 4 pozita, 2 pozita janë mbulue, por janë edhe 2 pozita tjera, për me u mbulue me shpalljen e konkurseve dhe kjo është arsyeja.

**Aziz Bici** – Pyes pse nuk i keni planifikue me kohë mjetet në Zyren e Kuvendit komunal dhe a ka ndryshue numri i punëtorëve, apo pse po kërkohen këto mjete. Në rast se kanë qenë mangu dhe nuk ka ndryshue numri i punëtorëve, pse nuk janë planifikue me kohë këto mjete.

**Zarife Behluli** – Përgjegjet se prej fillimit kanë qenë të buxhetume me mjete më pak. Çdoherë kur bëhet hartimi i buxhetit prej Qarkores së parë buxhetore në Qarkoren e dytë buxhetore, gjithmonë ndryshon vija e pagave që zvoglohet. Tash, për me ardhë te vlera e pagave te Drejtoria e Arsimit nuk na lejohet me bë

minusa dhe ne duhet me ardhë te vija që ta cakton Ministria, paga dhe meditje dhe për këtë arsye po i marrim te Arsimi fillor, mjetet dhe po i bartim te Zyra e Kuvendit.

**Burim Gërguri** – Në mbledhjen e KPF-së, kam kërkuar të formohen Komitetet konsultative dhe joobligative sepse jemi të obliguar sipas ligjit, prandaj edhe na duhen mjete shtesë për vitin 2019.

**Lulzim Sadiku** – Pyes se punëtorët me kontratë mbi veprën nga cila vijë paguhen.

**Burim Gërguri** – Përgjegjet se jemi duke folë për paga e meditje, e jo mallra dhe shërbime. Ju duhet ta dini se një njeri pa kontratë nuk mund të hyj në listë të pagave.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota “Për” dhe 3 vota “Kundër” (Lulzim Sadiku, Aziz Bici dhe Xhezide Dragusha) morën këtë:

## V E N D I M

**Miratohet vendimi për transferin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike Paga dhe Meditje.**

### **6.Pika e gjashtë e rendit të ditës -**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën e Handikos-it, dhe ne çdo vit e kemi trajtue këtë kërkesë, por nga ky vit e tutje, do ti marrin shërbimet në formën tjetër për shkak të rekomandimeve të auditorit.

**Eljesa Terbunja**, përf.i Handikos-it – Ne kërkesën e kemi bërë si zakonisht, vetëm ia kemi shtue edhe 4,000 €, që e kemi pa të arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara ti dërgojmë në ndonjë rehabilitim në banjë, ose në deti.

**Zarife Behluli** – Krejtë OJQ-të, krejtë klubet që janë në Komunën e Obiliqit, kulturë, rini dhe sport dhe Handikos-i, kanë qenë të detyruar me i sjellë kërkesat e tyre, por kjo nuk do të thotë se në vitin 2019, të gjitha dëshirat e tyre plotësohen. Këto kërkesa nuk ka nevojë të votohen sepse vendimet bëhen në vitin e ardhshëm, merret masa sa është subvencionimi për të gjitha kategoritë dhe ndahen në bazë të konkurseve.

**Fatos Kurshumlija** – Përderisa e dijmë gjendjen e njerëzve të Handikos-it, mendoj se ne si Kuvend kemi përgjegjësi jo me lënë kërkesën bashkë me atë të klubeve dhe të OJQ-ve tjera, por duhet me miratue. Meqë, po rritet buxheti i Komunës në 12, ose 13 milion €, mendoj se shuma prej 9,200 €, është pak për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe për organizatën e Handikos-it, që është në Komunën tonë.

**Lulzim Sadiku** – Vërtetë, kjo kërkesë po na vjen për çdo vjet duke filluar nga viti 2007, 2008, ne kemi ndarë mjete në këtë formë herë 4,000, e herë 5,000 €, dhe ne po flasim për një diçka që është shumë e ndijshme. Unë kërkoj që këtyre njerëzve t’ju ndihmohet në forma tjera, konkretisht kërkoj që t’ju bëhet një vend pune brenda Komunës, ose Drejtorisë së shëndetësisë dhe njëkohësisht të zgjidhet çështja e pagës. Ndërsa, për çështjen e shërbime gjithmonë jam për atë që t’ju ndajmë një shumë, por jo në formën qysh e ka sjellë kërkesën. Kërkoj që herave tjera, kur e sjellë kërkesën të na tregoj se çka ka bërë me mjetet që i kemi ndarë në vitin 2017, apo në vitin 2018, ku i ka harxhu dhe në çfarë forme. Unë gjithmonë kam qenë pro kësaj kërkesë dhe pasi që po shohë se kualicioni në Komunën e Obiliqit po punëson njerëz, kërkoj që të merret parasysh dhe të punësohet edhe Eljesa Terbunja dhe njëkohësisht të ndahen mjete sa për shërbime të atyre njerëzve me nevoja të veçanta. Mua, më duket se edhe ky vet po bie në lajthitje kur i vetmi person po bën ndarjen edhe për pagë, edhe për mallra dhe shërbime.

**Aziz Bici** – Mua, më vjen keq që iniciativa e tyre është vetanake dhe janë mundësi e vetme për të ndihmuar këtë kategori. Nuk duhet harruar se kjo kategori e qytetarëve tanë janë pjesë e shoqërisë tonë, prandaj është detyrë e qeverisjes, qoftë lokale apo qendrore që t’ju mundësojmë atyre përkrahje të vazhdueshme profesionale nga profesionistë shëndetësorë e social duke ju ofruar qasje që ju mundëson atyre një jetë sa më të dinjitetshme. Unë do të dëshiroja që në vend të kërkesës së mësipërme të lexoja për një projekt të përpiluar nga profesionistët e punëtorët social për krijim të kushteve për një jetë të dinjitetshme në plan afatgjatë.

**Ajet Berisha** – Pajtohem me z.Lulzim Sadiku, dhe ne kur flasim për Handikos-in, po flasim për një OJQ, e cila me aktivitetet e veta i bën disa shërbime për njerëzit e hendikepuar, por nuk po flasim për të hendikepuarit sepse ne përmes institucioneve tona, i kemi të planifikuar shpenzimet dhe aktivitetet tona që i bëjmë për këta njerëz. Ne e kemi gjetë një modalitet që Handikos-i, në Obiliq me i ofruar shërbimet që i kryen dhe ne me i ble ato shërbime. Mendoj se shërbimet duhet të ofrohen dhe ne e ofrojmë shumë e

mjeteve, që mendojmë se është normale. Më duket se ne me ligj kemi të drejtë ti kemi të punësuar 2 të hendikepuar, por nuk kemi të dejtë me i bë pagë dikujt nga OJQ-të.

**Hysni Mjeku** – Pajtohem se Komuna është e obliguar që në çdo 50 punëtorë, me punësue një të hendikepuar dhe kjo çështje është e rregulluar edhe me ligj.

**Lulzim Sadiku** – Unë realisht kërkova për shkak të numrit të punëtorëve 50, se duhet të jetë 1 punëtor dhe këtu është Nënktyetari që me pasë mundësi është mirë me gjetë një formë dhe me punësue. Sa i përket kërkesës, unë jam pro, por kërkoj që në mbledhjet e ardhshme të na vjen me sqarim se ku janë harxhues mjetet e vitit 2018, të na sjellë një listë se ku kanë shkue shpenzimet dmth me një plan të veprimit të dihet saktë se çka po ndodhë.

**Eljesa Terbunja** – Sa i përket shpenzimeve, mund të vini kur të doni, zyra e Handikos-it, është e hapur për të gjithë. Auditori i përgjithshëm, drejtoresha e financave kanë qenë dhe auditori në prezencën e drejtoreshës është falenderue për shpenzimet e bëra. Unë shumën e mjeteve e kam rritë duke parë se edhe buxheti është rritë, por kur nuk i kam mjetet me kohë, as planifikimin nuk mund ta bëjë si duhet.

**Burim Gërguri** – Rekomandim i auditorit ka qenë që forma e ndarjes së mjeteve mos të shkon me vendim të veçantë, por të ndahet nga subvencionet në mënyrë që të bëhet thirrje publike, për mos me pasë pengesa ligjore. Besoj se kjo kërkesë do të aprovohet në vitin 2019 dhe ky Kuvend komunal do të jetë përgjegjës për realizimin e saj.

#### **7.Pika e shtatë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën e BIK-ut, dega në Obiliq që anëtar në KKSB të jetë Irfan Hashani.

**Lulzim Sadiku** – Në vijën buxhetore, më heret kërkova dhe kërkoj prapë nga ata që kanë marrë vendim për përfaqësuesin e tyre në KKSB, që ta bëjnë një plan rregullativ për varreza në Komunën e Obiliqit, për të gjitha fshatrat sepse ne atyre ju kemi ndarë buxhet. Unë jam pro kësaj kërkesë.

**Aziz Bici** – Ne anëtarët e LVV-së, konsiderojmë se Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) nuk e kryen punën e vet, por është vetëm në shërbim të Ekzekutivit. Prandaj, një gjendje e tillë na bën neve, që të votojmë “Kundër” dhe jo vetëm, kundër zotëriut që e kanë propozuar ata, por kundër çdo anëtar sepse asnjë interes, asnjë të mirë nuk po e shohim prej këtij Këshilli.

**Burim Gërguri** – formimi i KKSB-së, është i bazuar në Udhëzimin Administrativ dhe e udhëheqë Kryetari i Komunës, ndërsa çështja e varrezave nuk është në domenin e Bashkësisë islame, por e di se DSHPE-ja, është duke punuar në Draft Rregulloren për rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave. Mendoj se në vitin e ardhshëm me plan të punës do të rregullohet kjo çështje.

**Nazmi Gashi** – Neve, s’na pengon që të votojmë për këtë çështje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota “Për” dhe 3 vota “Kundër” morën këtë:

#### **V E N D I M**

**Aprovohet kërkesa e Bashkësisë Islame në Obiliq, që përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame në Obiliq, si anëtar në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) të jetë Irfan ef.Hashani.**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën e grupit joformal të grave dhe zyres për barazi gjinore, e cila e ka një kosto prej 2,700. Kjo kërkesë shkon me kuotimin buxhetor gjinor nga mallrat dhe shërbimet për vitin 2019.

#### **8.Pika e tetë e rendit të ditës -**

**Labinot Mirena** – E kam një kërkesë të adresuar prej banorëve që billbordat ose posterat e partive politike, që janë të vendosur nëpër qytet ose banime kolektive, DSHPE-ja, duhet t’ju bëjë një kërkesë partive politike, që i kanë vendosë me i tërheqë ata postera. Mendoj se duhet me ua dhënë një afat prej 5 ose 10 ditësh, që ti largojnë sepse erërat e mëdha po i pengojnë banorët nëpër banimet e tyre dhe po paraqet rrezik.

**Lulzim Sadiku** – E kam një kërkesë për rr.Obiliq-Plemetin, që nëse dikush nga zyrtarët komunal shkon në atë rrugë dhe e shehë se në çfarë gjendje është. Unë nuk mund ti quaj policë të shtrirë sepse më vjen keq dhe kam shumë respekt për policinë tonë, por vërtetë janë disa pengesa aq të mëdha që në fakt nuk kalohet. Kërkoj që ato pengesa të hiqen për arsye se e pengon rr.Plemetin-Obiliq.

**Burim Gërguri** – Besoj se DSHPE-ja, do ta trajtoj këtë kërkesë bashkë me komunitetin që jetojnë atje.

**Qëndresa Krasniqi** – Unë e kam një kërkesë për Drejtorinë e Arsimit, se nxënësit në fshatin Lajthishtë janë të ngarkuar shumë me material shkollor dhe çantat e tyre janë të rënda. Mirëpo, edhe prindërit e tyre janë të shqetësuar sepse kanë edhe probleme shëndetësore për shkak të ngarkesës, prandaj për lehtësimin e tyre është mundësia e vendosjes së dollapëve.

**Burim Gërguri** – Besoj se Drejtoria e Arsimit, me reformat që është duke i bërë dhe Ministria e Arsimit e ka parasysh në planin e vitit 2019.

**Fatmir Bekteshi** – Unë e kam një pyetje për Kryetarin, por meqë nuk është këtu, po ia drejtoj drejtorit të infrastrukturës. E kam një vërejtje te magjistrallja, rruga që lidhë Obiliqin me Milloshevën, te lagjja e Shaljanëve janë duke u punuar aty punime të rrugës me siguri ujësjellësi, që tha Kryetari se e kemi një task forcë, ku është ajo task forcë që s'ka dalë që 10 ditë. Aty është një gropë dhe detyrohen njerëzit të ndalen sepse asfalti është i prerë, dhe pyes se kush e ka kontrolluar atë që kisha pasë dëshirë me shkue dhe me kontrollue.

**Burim Gërguri** – Sqaron se aty është bërë një prerje e rrugës, por është bërë për lagjen e re në Milloshevë. Përgjegje më konkrete për këtë çështje mund të japin drejtori i DSHPE-së dhe i infrastrukturës lokale. Lajmi i mirë është se rrjeti i vjetër i ujit të Obiliqit, është drejt fundit dhe po lidhet me fabrikën në Shkabaj. Investimet që janë bërë aty, janë bërë në kuadër të planit 2015-2019, me ndërrimin e gypave bashkarisht me donatorë, në mënyrë që të kemi cilësi të ujit të pijes.

**Enver Grajqevci** – Përgjegjet se rruga Hamidi-Sibofc, është në procedurë të Prokurimit dhe kjo mund të shihet edhe në faqe të KRPP-së, shpejt duhet të lidhet kontrata dhe unë gojarisht i kam thënë edhe z.Lulzim Sadiku, se sivjet do të lidhet. Në rast se vozitet sipas shenjave, edhe aty dëmi nuk mund të jetë i madh, por ne e kemi edhe rr."Aziz Zhilivoda" që së shpejti do të asfaltohet dhe ajo vijë ku është futë ai gyp i ujit, do të mbyllet. Ai gyp ka hy për disa lagje dhe janë rreth 60 ekonomi familjare.


**Lulzim Sadiku** – Vërtetë, unë brenda Komunës së Obiliqit, e kam një respekt më së shumti për z.Enver Grajqevcin, e kam mik dhe shok, por realisht drejtor edhe rr."Ymeri" që është në lagjen time, ka kalue në vitin 2014 me buxhet dhe asnjëherë nuk është krye. Unë po flas për situatën që jemi, e kam humb besimin derisa po kaloj mbi të dhe unë besoj te ti, të shohim se a po kryhet apo jo. Unë pa e pa që kryhet nuk mund të them se kryhet për atë dhe mendoj se ajo rrugë dhe urë është momentalisht e lidhur me ato fshatra, që mendoj se është bërë një punë e mirë.

**Labinot Mirena** – E kam një kërkesë këtu, te xhamia të vendoset një shenjë ndalim parking sepse ne si banorë aty kemi shumë telashe me njerëzit që vijnë aty, nëpër institucione dhe kafene për arsye se rruga bllokohet. Unë shumë herë i kam ftuar edhe policinë aty, por nuk kanë ditë qysh me veprue sepse nuk ka pasë shenjë që është ndalim parking në atë rrugë. Sa i përket rrugës te Millosheva, ne nuk jemi kundër atyre banorëve që ua keni dërguar ujësjellësin, ne jemi pro dhe krejtë çka është në të mirën e qytetarëve ne e përkrahim. Mirëpo, nëse rruga nuk e don vozitjen 60 në orë aty, a vjen Komuna me ua rregullue veturat, sepse 60 në orë prishen.

**Burim Gërguri** – Kërkesat janë jashtëzakonisht me vend dhe besoj se drejtori i DSHPE-së dhe i infrastrukturës i kanë parasysh këto kërkesa.

**Mbledhja përfundoi në ora 13:40'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

**Kryesuesi i Kuvendit komunal**

  
Burim Gërguri

